



Lajmëtari i Radio Marisë

Dhjetor 2011

Viti III, Nr. 12

Në këtë numër do të lexoni

- Fjalimi i Presidentit të Familjes Botërore të RM, z. Emanuele Ferrario 2
- Festa e Radio Marisë në Detroit, SHBA 3
- Poezi për Radio Marinë 3
- Lajmërime të ndryshme 4

Lajmëtari i Radio Marisë është organ i Shoqatës Radio Maria.

Tiranë

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 4
Fushë Kërçik, Babrru, Paskuqan
Tiranë, Shqipëri
+355 4 2 346 346

Shkodër

Sheshi Papa Gjon Pali II
Shkodër, Shqipëri
+355 22 24 08 52

Lezhë

Sheshi Besëlidhja
Lezhë, Shqipëri
+355 215 24 970

E-mail: info@alb.radiomaria.org

Përgjegjës

Don Prekë Lazraj

**Radio Maria,
Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde,
mund të dëgjohet në:**

Brëshen e rrethina
FM 100.7 MHz

Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat
FM 91.4 MHz

Shkodër, Podgoricë, Ulqin
FM 102.2 MHz

Lezhë, Laç të Kurbinit, Mamurras
FM 89.6 MHz;

Pukë, Fushë Arrëz, Tropojë,
Kukës dhe Kosovë

FM 90.0 MHz

www.radiomaria.al

KOHA E ARDHJES



Fjala ardhje vjen nga fjala latine adventus. Kjo kohë përbëhet prej katër javëve liturgjike para Kërshëndellave, në të cilat Kisha përgatitet për të kremtuar lindjen e Zotit tonë Jezu Krishtit, por përgatitet gjithashtu edhe për ardhjen e tij të dytë. Koha e Ardhjes fillon me të dielën më afër datës 30 nëntor, që është festa e Shën Andreut Apostull, që quhet edhe e diela e parë e ardhjes. Në këtë ditë fillon edhe viti Kishtar.

Leximet dhe zakonet e kohës së Ardhjes theksojnë pendesën dhe pritjen e gëzueshme të Zotit tonë Jezu Krishtit. Që nga e diela e parë e deri më 16 dhjetor, liturgjia na drejton në pendesë dhe në përgatitje për ardhjen e dytë të Zotit përmes leximeve që shpallin profetizimet mesianike të Shën Gjon Pagëzuesit dhe të Isaisë, ndërsa pjesët e Ungjillit tregojnë dhe përshkruajnë Jezusin si atë që i plotëson këto profetizime.

Gjatë kohës së Ardhjes, petkat liturgjike që vishen në Kishë janë ngjyrë vjollce. Kjo gjë që dëshiron të tregojë temën e pendesës. Përveç kësaj, në secilën të diel të Ardhjes ndizet një qiri i ri në kurorën e ardhjes. Flaka e qirinje

shtohet për çdo të diel me flakën e qiriut të ri që ndizet duke e shtuar kështu dritën e ardhjes dhe duke dashur që të tregojë para secilit besimtar se tashmë Zoti është afër, se Jezu Krishti është drita e vërtetë që vjen në botë.

Në javën e fundit të ardhjes, liturgjia përqendrohet në mënyrë të plotë në lindjen e Jezu Krishtit, duke treguar rolin e Nënës së Krishtit si atë që na ndihmon për t'u përgatitur dhe për ta pranuar.

Kremtimi i kohës së ardhjes filloi në shekullin IV, duke e ftuar secilin besimtar që të përgatitet për kremtimin e Kërshëndellave. Perpetusi, ipeshkvi i Toursit, në vitin 490, e shpalli zyrtarisht kohën e ardhjes si kohë pendese në Kishën e frakëve, duke e caktuar pendesën gjatë tri ditëve të javës që nga festa e Shën Martinit, më 11 nëntor, e deri në ditën e Kërshëndellave. Këto ditë ishin ditë pendese në përngjasimin e dyzet ditëve të pendesës së kreshmëve, që në gjuhën origjinale quhet: "Quadragesima Sancti Martini" (Dyzetditëshi i Shën Martinit) dhe leximet e liturgjisë së shenjtë merreshin nga koha e kreshmëve.

Koha e ardhjes në liturgjinë e Romës, që do të zhvillohet një shekull pas asaj të Kishës së frankëve, nuk ishte pendestare, por kohë gëzimi dhe e përgatitjes për Kërshëndella. Kur Kisha e njësoi kohën liturgjike, natyra e gëzueshme e liturgjisë romake kundërshtonte natyrën pendestare të kishës së Galisë.

Vetëm në shekullin XIII u arrit kompromisi, që bashkoi pendesën dhe natyrën pendestare të mënyrës së kremtimit në Gali me leximet e Meshës që përdorëshin në liturgjinë romake gjatë kohës së ardhjes. Kjo liturgji mbeti e pandryshuar deri në Koncilin II të Vatikanit, i cili bëri ndryshime të vogla duke e përcaktuar qartë shpirtin e kohës së ardhjes dhe të kohës së kreshmëve.

Jemi të ftuar që në kohën e ardhjes të jetojmë me gëzim secilin moment pendestar që na përgatit për ardhjen e Zotit tonë Jezu Krishtit. Ta shfrytëzojmë çdo çast për ta jetuar siç do Ai që të lindë në zemrën e secilit.

Don Preka

DYDITËSHI I RADIO MARIË - FJALIMI I PRESIDENTIT EMANUELE FERRARIO

Të dashur miq, dëgjues të Radio Marisë,

Jemi në përfundim të transmetimit “Dy ditë me Radio Marinë” me titull “Dishepujt e Marisë, misionarë të Jezusit” dhe me kënaqësi, si president i Familjes Botërore, kam mundësi të bisedoj me ju anëtarë, dëshmitarë të kësaj familje të madhe, që përqafton pesë kontinentet dhe që ecën çdo ditë në shembullin e Nazaretit.

Sot na kanë dëgjuar në 58 shtete dhe megjithëse është një arritje e mirë, ja që edhe pse jemi të pranishëm në 17 kombe afrikane, duhet të vëmë re që fort i dashuri Ati i Shenjtë, Benedikti XVI, po na shoqëron në Benin, ku Radio Maria nuk është ende e pranishme dhe kjo është shenja se na pret ende një punë e madhe. Falë Zotit, thirrjet për të hapur Radio Mari të reja nuk mungojnë, veçanërisht nga Afrika dhe Azia, që janë toka misionare dhe janë dy kontinentet në të cilat Kisha ka një numër më të madh të pagëzuarish. Siç e dini, misioni ynë nuk është i ndonjë rendi politik apo ekonomik, por ka natyrë fetare. Qëllimi ynë është që ta ndihmojmë Kishën katolike në veprën e saj ungjillëzuese, duke ndjekur projektin tonë që duam t’ia kushtojmë Virgjërës së shenjtë.

Ne, dëgjues të dashur, e duam Radio Marinë, sepse na rrit në njohjen e së vërtetës së fesë, na ndihmon të lutemi, na jep qetësi duke na ndihmuar në ecjen e jetës siç e vërtetojnë dëshmitë e shumta. Porse Zoja mund të na thërrasë në diçka më sfiduese: mund të na thërrasë të jemi fara e mirë, e cila “në tokë të mirë i qindfishon frytet e saj”.

Prandaj, çfarë duhet të bëjmë? Secili prej nesh e kupton që kjo është një periudhë shumë komplekse, në të cilën Kisha është duke vuajtur shumë dhe i nënshtrohet sulmit të forcave të së keqes, prandaj do të mjaftonte një përpjekje e vogël nga të gjithë ne, në mënyrë që projekti ynë të përhapet më shumë, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në botë. Kështu e thjeshtësojmë takimin e pazëvendësueshëm të personave të rinj me Krishtin dhe Ungjillin.

Çdo vend e ka lidhjen e vet me drejtorin, i cili çdo ditë është i pranishëm në radio me programin e tij dhe ju informon mbi ecjen e radios në vendin tuaj, ashtu siç edhe i njihni drejtuesit që ndërrojnë njëri-tjetrin në mikrofon, por edhe ata që me studiot lëvizëse ju mundësojnë ta dëgjoni Meshën e shenjtë nga famullitë e ndryshme.

Jam i sigurt që të gjithë ju luteni për rritjen e Radio Marisë në vendin tuaj dhe në botë. Atëherë pse të mos i përgjigjemi edhe thirrjes për të bërë pjesë në ushtrinë e vogël të “milingonave”, që në çdo anë të botës vendosen në shërbim të radios?

Me fjalën milingona, kohë më parë, quheshin ata dëgjues që ndjehen të thirrur në zemrën e tyre të japin talentet e tyre me thjeshtësi, përvujtëri dhe punë të madhe, duke dhuruar një pjesë të kohës së tyre në shërbim të Zojës. Një milingonë mund të bëjë shumë, nëse nuk ka frikë ta tregojë fenë e vet, nëse bën të njihet radioja në lagjet, në fshatin ose në qytetin e vet.

Ndokush mund t’ju përqeshë, por ka çaste në jetë, në të cilën njeriu është në kërkim të një fjale që mund t’ia ndërrojë jetën, duke ia sjellë lumturinë e vërtetë. Një milingonë mund të bashkohet me dëgjues të tjerë dhe të krijojë në grup të vogël. Ka të paktën 30 milionë njerëz që e dëgjojnë Radio Marinë çdo ditë dhe mendoni sikur të bëheshin 30 milionë milingona dhe, siç na ka thënë Zoti ynë, fara në tokë të mirë.... qindfishohet. Ne nuk i dimë mirë numrat, por besojmë verbërisht në Mëshirën Hyjnore, e cila i njeht numrat më mirë se ne.

Radio Maria është një rreth që i përqafton të gjithë, secilin me dhuratat e veta dhe rrethi mund të zgjerohet pa masë, duke përfshirë jo vetëm misionin e Radio Marisë tuaj, por edhe Radio Marinë e një kontinenti tjetër. Është zgjerimi i Po-së më të madhe të historisë, Po-ja ndaj jetës, Po-ja ndaj familjes, Po-ja ndaj vullnetit të Hyjit që gjendet në buzët e Zojës. Duam ta shpallim këtë PO me Radio Marinë tonë. Shpeshherë zemra i reziston ndryshimit, por në anijen e jetës tonë, gjenden si koha, ashtu dhe energji të padysimta kur udhëheq Zoti. Në lidhje me këtë, kujtoj që një nga milingonat më të mira ishte një njeri i sëmurë e i paralizuar në shtrat për shumë vite me radhë. Njerëzit mund të na zhgënjëjnë, por Virgjëra Mari nuk na ka zhgënjyer kurrë në punën për ta çuar përpara shëlbimin e botës, fryt i vdekjes dhe i ringjalljes së Birit të saj, Jezusit. Maria nuk njeht kufij dhe shfaqet në vendet dhe në personat më të thjeshtë, ashtu si valët e radios që nuk njohin kufij dhe arrijnë larg e na ndihmojnë të krijojmë bashkësi.

Dhe tani, përpara se ta mbyll, do të doja ta përshëndesja përzemërsisht secilin prej jush nga kombi në komb, por do të ishte një kohë pa mbarim, prandaj po kufizohem me një falënderim nga kontinenti në kontinent duke filluar nga shtëpia jonë, nga Evropa me rrënjët e saj të krishtera shumë shpesh të mohuara.

Faleminderit 20 Radio Marive evropiane, prej të cilave 18 janë radio kombëtare dhe 2 të kushtuara pakicave gjuhësore, njëra e gjuhës gjermane, e pranishme në Itali, dhe tjetra e gjuhës hungareze, e pranishme në Rumani. Në Evropë kemi shumëllojshmëri gjuhësh, por dashuria e përbashkët për projektin bën që të tejkalohen këto pengesa.

Të kalojmë tani në kontinentin amerikan me 22 Radio Maritë e tij, tre prej të cilave i janë kushtuar pakicave gjuhësore të gjuhës spanjolle dhe italiane. Kohët e fundit kemi pasur një takim në Guatemalë me drejtorët, presidentët dhe koordinatorët e radiove dhe më ka mbetur në zemër entuziazmi i tyre, rritja e tyre në fe dhe në vetëdijen e misionit, që është fryt i pjesëmarrjes tuaj konkrete.

Dhe tani le të flasim për kontinentin afrikan që është në qendër të vëmendjes sonë, veçanërisht pas konventës tonë botërore në vitin 2009, që na ka nxitur t’i përgjigjemi shumë thirrjeve të shumë ipeshkvijve e laikëve të kushtuar që e kërkojnë një Radio Mari. Nga përpjekjet e krejt Familjes Botërore u finalizua, me ju vëllezër të Afrikës, jo vetëm një rrjet radiofonik, por një rrjet vëllazërie dhe ungjillëzimi edhe përmes binjakëzimeve me radiot e kontinenteve të tjera, duke krijuar një lidhje të përfaqësuar nga këta tela të dashurisë që e rrethojnë krejt botën. Dhe në vitin e ardhshëm, 17 Radio Maritë e pranishme në kontinentin afrikan bëhen 20.

Tani dëshiroj të përshëndes dëgjuesit e Azisë dhe Oqeanisë, edhe pse atje tashmë është e diel. Ju jeni fara që do të japë fryte të mëdha... jemi më se të sigurt për këtë. Tani jemi të pranishëm vetëm në 4 shtete, por kemi edhe dy thirrje të reja.

Në përfundim, e kam një përshëndetje të veçantë për radiot e lindura këtë vit: të dashur dëgjues të Kamerunit, welkom an onse belchise lesteraars të dashur dëgjues të Belgjikës, Akwaba të dashur dëgjues të Bregut të fildishtë, të dashur dëgjues të Indisë.

Dhe tani një falënderim të gjithë atyre që kanë ndihmuar në realizimin e këtyre dy ditëve në kontinentin të ndryshme, por veçanërisht faleminderit Virgjërës së Shenjtë që na zgjodhi një e nga një në këta 30 milionë që jemi. Asaj ia kërkojmë dhuratën e përvujtërisë dhe rrugën që na udhëheq shumë larg, dhuratën e fesë dhe të dashurisë.

Me këto dhurata, ne të premtojmë, o Virgjër e Bekuar, se do të vazhdojmë të punojmë përkrah teje, duke të ta ofruar ty atë pak që kemi dhe mjerimin tonë.

Me mirënjohje të thellë ndaj të gjithëve,

FESTA E RADIO MARISË NË DETROIT, SHBA

Më 6 nëntor 2011, nën drejtimin e Presidentit të Radio Marisë në Detroit, z. Kanto Dushaj, Drjetorit të programit, z. Martin Camaj, dhe nënkryetarit, z. Franc Grishaj, u kremtua festa e dytë e Radio Marisë në këtë qytet verior të SHBA-së.

Përpara festës, u mbledh një grup miqsh të Radio Marisë, me në krye famulltarët Don Fran Kolaj, famullia e "Shën Palit", dhe Don Ndue Gjergji, famullia "Zoja Pajtores e Shqiptarëve", për të planifikuar organizimin e festës. Në këtë mbledhje shpenzimet për festën i morën përsipër, pra barrën më të madhe, Don Fran Kolaj, i cili ofroi çdo gjë falas për organizimin sa më të mirë të kësaj ngjarjeje të rëndësishme për Radio Marinë. E dhanë ndihmesën e vet edhe Don Ndue Gjergji, Nikollë Gegaj, Kol Gurraj, Gjelina Camaj, Nosh dhe Gjon Ivezaj, Rrok Vuktilaj, Ben Fugaj, Shoqata Atë Gjergj Fishta, Martin Camaj, Franc Grishaj, etj.

Disa ditë përpara festës u bë një paraqitje e Radio Marisë në Televizionin e Shqiptarëve në Detroit, që drejtohet nga z. Gani Vila. Një javë pas festës, ai e transmetoi gjithashtu edhe zhvillimin e festës në të njëjtin televizion, për çfarë e falënderojmë.

Darka ishte paraparë që të niste në orën 18:30, por njerëzit filluan të vijnë që në orën 17:30. Në këtë mënyrë ia nisi të mbushej salla "Gjergj Kastrioti" me të ftuar të Zojes së bekuar, të cilët kishin për qëllim, si edhe dy vite më parë, që të jenë së bashku si një familje që bashkohet rreth Nënës për të marrë këshillat e saj, të cilat na i dha përmes bijve dhe bijave të zgjedhura. Ajo na foli përmes drejtuesve të programit, z. Franc Grishaj dhe zj. Katrina Ballabani, përmes këngëtarëve Kolë & Hanë Nikprelaj, Prekë Shkreli, Analisa Camaj dhe drejtuesit të muzikës, Beko Gjelaq, përmes Presidentit, z. Kanto Dushaj, Don Fran Kolaj, Don Anton Kçirës, Don Ndue Gjergjit, Prekë Ivezajt, Ndrej Gurit. Në këtë mbrëmje, foli edhe drejtori i Radio Marisë Shqiptare, Don Prekë Lazraj, i cili bëri një paraqitje pamore të veprimtarisë së Radio Marisë gjatë këtyre nëntë viteve në Shqipëri e më gjerë.

Rreth 350 vetë të pranishëm shikonin të mahnitur veprën e mrekullueshme, të cilën Zoti e filloi dhe po e çonte përpara në popullin shqiptar, duke u ngutur që sa me kontributin personal të ndihmojnë që kjo vepër hyjnore të shkojë përpara dhe të zhvillohet sipas vullnetit të Zotit. Një ndihmesë të konsiderueshme, edhe kësaj here e dha fondacioni "Don Prekë Ndrevasaj".

Kaluan në gëzim familjar më shumë se pesë orë. Iu kënaqëm njëri-tjetrit dhe e falënderuam Zotin që na zgjodhi pikërisht neve që ishim më të vegjlit e bashkësisë, që më vogëlsinë tonë të marrim pjesë në veprën e madhe që Ai po e çon përpara duke gëzuar me shëlbim zemrat e hapura përpara hirit që në vazhdimësi e transmeton Radio Maria Shqiptare në krejt skajet e botës.

Të lutemi që sa më parë shqiptarët që jetojnë në Detroit dhe në rrethina ta dëgjojnë Radio Marinë 24 orë, ashtu si dëgjohet në Shqipëri, Mal të Zi dhe në Kosovë.

Stafi i Radio Marisë falënderon të gjithë organizatorët dhe të gjithë pjesëmarrësit në festës, duke iu premtuar lutjen e përditshme dhe një herë në javë, të premtëve, Meshën e shenjtë për të gjitha nevojat që mund të kenë miqtë dhe bamirësit e Radio Marisë në të katër anët e botës.

POEZI PËR RADIO MARINË



Jam i vjetër dhe i pashkollë,
M'bëtë ta marr prapë lapsin në dorë.
Ndoj' gabim që ka me m'dalë,
ju besoj keni me m'fal.

Falënderimin po e filloj
për atë që na e dhuroi.
Zoti i madh, ti k'josh bekuar,
për çdo t'mirë që na ke çue.

Gëzim të madh ka në Shqipëri,
na dha Zoti një Shën Pal t'ri.
Emri i tij Radio Mari
e pranishme në çdo shtëpi.

T'falënderojmë, o i madhi Zot,
na dhurove t'mira plot.
T'shpallim fenë, t'jemi n'liri,
si dikur në lliri.

Si dikur para shumë motit,
si në kohë t'Gjergj Kastriotit.

Ti paç dritë Marin Barleti
Ku të t'gjej s'kam unë i shkreti
T'përjetësosh për'sri atletin,
jo me shpatë, por me uratë.
Se kështu Krishti ne na mëson,
lutjen tonë kështu e dëgjon.

Me ne lutet Zoja lume
tuj na sjell jetë të bekueme.
Që të jetojmë mirë në Shqipëri,
si dikur në lliri,
veç në paqe, me dashuri.

O Mari, ty t'k'joshim falë,
Jezu Krishtin na e ke dhanë.
Ndërmjetëso te Biri jot,
që të kemi meshtarë plot,
si dikur pat' Shkodra jonë,
që Ungjillin t'predikojnë.
Sepse këtu s'pat kurrë mungesë,
S'na munguan kurrë t'parët e fesë.

Historia jonë shumë e vjetër,
fatbardhësisht s'ka mbetë në letër.
E kaluara ka dëshmue,
martirët tanë janë pushkatue,
tuj dhanë jetën si me le
për binom «fe» e «atdhe».

Por ne patëm një fat të rrallë,
do meshtarë na mbetën gjallë.

Në mes tyne një vigan,
Mikel Koliqi "Kardinal".

Vazhdon prap kjo histori,
Na fal Zoti meshtarë t'rinj.
Zoti i madh t'gjithë me i bekuar,
martirët tanë me na i nderue.

Për në fund lash unë ma t'parin,
që n'këtë kohë iu fal shqiptarit.
I lumi ai që asht kujtue
n'Shkodrën tonë për me e fillue.
Shpërbleji Zot kush ka ndihmue,
Hiri yt n'çdo shtëpi me shkue.

Shpërbleji Zot plot me dashni
Me ma t'madhen lumturi.
Shumë gëzim pruni n'Shqipni
Tash po rritet pop'lli ri.
Mbushi plot me t'mira n'jetë
Jepju t'gjithëve paq' t'vertetë.

Prekë Palaj, Shirq

EMISIONE TË REJA NË RADIO MARI

Në Radio Mari, gjatë muajit nëntor, krahas përshtirësish për shpirtat e purgatorit, filluan edhe disa emisione të reja.

Më 7 nëntor, famullitari i Famullisë Zoja Nunciatë në Lezhë, Atë Flavio Cavallini, bashkë me një grup besimtarësh të kësaj famullie, drejton Vatrën Biblike çdo të hënë, në orën 20:00. Ky është një emision që ka në qendër lutjen, dëgjimin e Fjalës së Zotit dhe bashkëndarjen e saj me dëgjuesit, të cilët formojnë edhe ata në shtëpitë e tyre një vatër që ndizet nga dashuria për Fjalën.

Imzot Ottavio Vitale, Ipeshkvi i Dioqezës së Lezhës, ka filluar transmetimin e 25 katekezave për familjen, që transmetohen një herë në muaj.

Më 17 nëntor, Antonino ka filluar emisionin e përvajshëm me titull "Katekizmi yt", që transmetohet çdo të enjte, në orën 18:30.

Më 25 nëntor, nga studioja e Radio Marisë në Lezhë janë lutur luja e orës 21:00 dhe është kremtuar për herë të parë Mesha e shenjtë nga kjo studio.

Takimet me vullnetarët mbahen në këto ditë: në Shkodër - çdo të premte në orën 16:00, në Tiranë - çdo të mërkurë në orën 15:00, në Lezhë - çdo të hënë në orën 13:30. Jeni të mirëseardhur.

DYDITËSHI I RADIO MARISË

Më 18 e 19 dhjetor, u kremtua për të shtatën herë Dyditëshi i Radio Marisë me titull: "Dishepujt e Marisë, misionarë të Jezusit". Ishim në lidhje të drejtpërdrejtë me 58 radiot kombëtare dhe me 16 radiot që në vende të ndryshme të botës transmetojnë për pakicat etnike. E falënderojmë Zotin për këtë hir të veçantë që na e dha për t'u bashkuar me të gjithë dëgjuesit nëpër botë, më shumë se 30.000.000 njerëz. Kështu patëm mundësi të mësojmë, të lutemi dhe të meditojmë së bashku.

KALENDARI I RADIO MARISË PËR VITIN 2012

Doli nga shtypi kalendari i Radio Marisë për vitin 2012, i cili i kushtohet promovimit të saj në mbarë Shqipërinë. Në të përfshihen të gjitha të kremtet, festat dhe përkujtimet liturgjike, si edhe shenjtërit e ditës. Kalendarin mund ta gjeni në të treja studiot e Radio Marisë në Tiranë, Shkodër dhe Lezhë. Mund të kontaktoni edhe vullnetarët tanë në terren për informacione.



NË SHQIPËRI
PRO CREDIT BANK
 LLOGARIA NË EURO 600388970102
 KODI SWIFT: FEFAALFR
 IBAN: AL 45209516090000600388970102

NË ZVICËR
ME 5 FRANGA DUKE TELEFONUAR
 NË NUMRIN: 0900 123411
 OSE
PËRMES BANKËS CREDIT SUISSE
 RADIO MARIA
 LLOGARIA NË CHF 361173-10-1
 IBAN: CH 18 085 5036 1173 10001

NË SHBA (USA)
ALBANIAN RADIO MARIA
 P.O. BOX 1378
 STERLING HEIGHTS MI, 48311
BANKA CHARTER ONE
 ROUTING #: 26100147
 ACC. #: 4514288150

Radio Marisë mund ta dëgjoni në:
 Brukseli e zviceranë - 178 100.7 MHz; Tiranë, Durres, Kavajë, Berat - 174 91.4 MHz; Shkodër, Pogradec, Ugin - 174 100.2 MHz;
 Lezhë, Lajç Kurbidh, Mamurras - 174 91.4 MHz; Prizren, Pezë, Korçë, Tropishtë, Kukës dhe Gjirokastrë - 174 90.0 MHz;
 www.radiomaria.al

Mund të na kontaktoni në:
 Rt. Papa Gjoni Pallatit, Nr. 4, Fshatë Kërcirë, Zërrë, Peshkëmbë, Tiranë, Shqipëri 4555 4 2 346 346
 Shërbë Papa Gjoni Pallatit, Rr. Shkollë, Shqipëri 4555 22 24 08 52
 Shërbë Kërcirë, Lushnjë, Shqipëri 4883 215 24 490
 E-mail: info_al@radiomaria.org Facebook: Radio Maria Albania

PRO CREDIT BANK
LLOGARIA NË EURO 600388970102
 Kodi SWIFT: FEFAALFR
 IBAN: AL 45209516090000600388970102
LLOGARIA NË LEK 600388970001
 Kodi SWIFT: FEFAALFR
 IBAN: AL 56209516090000600388970001

INTESA SAN PAOLO BANK
LLOGARIA NË EURO 1043631803
 Kodi SWIFT: USALALTR
 IBAN: AL 25208110080000001043631803
LLOGARIA NË LEK 1043631801
 Kodi SWIFT: USALALTR
 IBAN: AL 79208110080000001043631801

NË ZVICËR ME 5 FRANGA
Duke telefonuar në numrin:
0900123411
Në bankën CREDIT SUISSE
RADIO MARIA
LLOGARIA NË CHF 361173-10-1
IBAN: CH1804835036117310001